



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 418/3 prot.

Tiranë, më 28. 05. 2026

**V E N D I M**

**Nr. 125, datë 28. 05. 2026**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar<sup>2</sup>, shqyrtoi ankesën nr. 55 Regj., datë 24.02.2026, të subjektit ankues V. Q., kundër Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim, për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”<sup>3</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>4</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, V. Q. prej datës 28.10.2025, ka nënshkruar Kontratë Huapërdorje me Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike të Bashkisë Tiranë dhe është strehuar në një nga banesat sociale të Bashkisë Tiranë. Ankuesi referon se ndodhet në kushte të vështira shëndetësore dhe sociale. Sipas tij, më datë 23.02.2026, nga ana e punonjësve të OSHEE-së i është ndërprerë furnizimi me energji elektrike në banesë (me Nr. Kontrate me OSHEE: TR2T120225634310), për shkak se kontrata rezulton debitore ndaj këtij institucioni.

Në këto kushte, ankuesi i është drejtuar zyrave të Kujdesit ndaj Klientit të OSHEE-së dhe është informuar se nuk mund të lidhë një kontratë të re apo të paguajë faturat e energjisë elektrike, që nga data 03.11.2025, kur është strehuar në këtë banesë, për shkak të detyrimeve të prapambetura dhe debisë së akumuluar të kontratës së kësaj banese. Sakaq, ankuesi sqaron se është në gjendje të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën “LMD”.

<sup>3</sup> Referuar Vërtetimit për lloj dhe masë pensioni të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, datë 18.03.2025, vërtetohet se V. Q. përfiton pension Invaliditeti Urban, në masën 34.360 lekë.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

paguaj faturat e energjisë elektrike që nga momenti që ai është strehuar në këtë apartament, datë 03.11.2025, por jo debinë e cila duhet të mbulohet nga ana e Bashkisë Tiranë.

Sa më sipër, ankuesi pretendon se është vënë në pozita diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi si rezultat i debisë së akumuluar prej saj ndaj OSHEE-së, për apartamentin që ai ka në përdorim, ka mbetur pa energji elektrike dhe për pasojë pa ngrohje.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Bashkisë Tiranë, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për rilidhjen e energjisë elektrike dhe pagesën e debisë për apartamentin që ai ka në përdorim aktualisht.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara*

nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre...”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Me shkresën nr. 418/2, datë 25.02.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Bashkia Tiranë dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE), lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
  - Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e secilit subjekt ankues.
  - Kopje të dokumentacionit që disponohet prej jush sa i përket debisë së apartamentit me Nr. Kontrate me OSHEE: TR2T120225634310.
  - Informacion nëse deri aktualisht janë ndërmarrë masa lidhur me zgjidhjen e kësaj problematike. Nëse po, kopje të dokumentacionit provues.

Me shkresën<sup>5</sup> nr. 941/1, datë 04.03.2026, Bashkia Tiranë, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Në zbatim të Rregullores së Brendshme “Për Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkia Tiranë Nr. 1264/2024, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e banesave sociale dhe programet e strehimit social, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale, ushtron kompetencat e saj në fushën e administrimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të përdorimit të banesave sociale në zonën e Shkozës, ish-“Fonderia Mek”, duke garantuar zbatimin e vendimeve të Këshilli Bashkiak Tiranë dhe akteve nënligjore përkatëse.

<sup>5</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 418/2 prot., datë 10.03.2026.

*Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale ka kompetencë ligjore për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale, për lidhjen dhe monitorimin e kontratave të qirasë apo huapërdorjes me përfituesit, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të detyrimeve që burojnë nga këto marrëdhënie kontraktore. Kjo kompetencë përfshin garantimin e përdorimit të rregullt të banesës sipas destinacionit dhe kushteve të përcaktuara, por nuk shtrihet në marrjen përsipër apo administrimin e detyrimeve individuale financiare që përfituesit kanë ndaj operatorëve të shërbimeve publike, pasi këto përbëjnë marrëdhënie të drejtpërdrejta juridike ndërmjet përfituesit dhe operatorit përkatës.*

*Nga dokumentacioni administrativ rezulton se V. Q. është akomoduar në banesën me adresë Kompleksi “Fusha”, shk. 2, ap. 3/1, më datë 28.10.2025, moment në të cilin është kryer dorëzimi i banesës dhe ai ka marrë në përdorim të plotë ambientin. Në çastin e dorëzimit ai është informuar për ekzistencën e një debie të mbartur nga përfituesit e mëparshëm në lidhje me furnizimin me energji elektrike, si dhe është sqaruar shprehimisht se përgjegjësia e tij financiare fillon nga data e marrjes në dorëzim të banesës, përkatësisht për konsumin e realizuar prej tij nga muaji Nëntor 2025 dhe në vijim.*

*V. Q. i është bërë me dije se çdo detyrim për pagesën e energjisë elektrike, përfshirë komunikimin me operatorin, lidhjen apo rregullimin e kontratës së furnizimit dhe zgjidhjen e çdo problematike të mundshme, rregullohet nga marrëdhënia e tij e drejtpërdrejtë me operatorin e furnizimit dhe nuk përbën përgjegjësi të administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike.*

*Në muajin Shkurt 2026, V. Q. është paraqitur pranë zyrave të Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale duke njoftuar për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike në banesën e tij. Pas verifikimeve të kryera dhe komunikimit me operatorin përkatës, rezultoi se nuk ishte kryer asnjë pagesë për konsumin e muajve Nëntor 2025, Dhjetor 2025 dhe Janar 2026. Si pasojë e mospërbushjes së këtij detyrimi financiar për periudhën në të cilën ai ka qenë përdorues i banesës dhe konsumator i energjisë elektrike, operatori kishte proceduar me ndërprerjen e furnizimit, në përputhje me kushtet kontraktore dhe rregullat e zbatueshme për rastet e mospagesës.*

*Pas komunikimit të mëtjshëm me V. Q. dhe familjare të tij pranë zyrave të Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale, është kryer pagesa e detyrimeve të papaguara për periudhën përkatëse. Sipas informacionit të konfirmuar nga operatori, më datë 26.02.2026 është kryer rilidhja e energjisë elektrike në banesën në përdorim nga V. Q.*

*Në përfundim, sqarohet se Drejtoria e Administrimit të Banesave Sociale ka vepruar në përputhje të plotë me kompetencat e saj ligjore dhe funksionale, duke administruar banesën sociale sipas kuadrit rregullator në fuqi dhe duke informuar në mënyrë të qartë përfituesin mbi detyrimet që lidhen me përdorimin e saj. Detyrimet që burojnë nga furnizimi me energji elektrike, përfshirë pagesën e konsumit, debinë, ndërprerjen apo rilidhjen e shërbimit, përbëjnë marrëdhënie juridike ndërmjet përfituesit dhe operatorit të shërbimit dhe, si të tilla, mbeten jashtë juridiksionit dhe përgjegjësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike... ”.*

Me e-mail-in datë 12.03.2026, Shoqëria OSHEE sh.a., informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi i kryer në sistemin e faturimit të FSHU SH.A., rezulton se kontrata e furnizimit me energji elektrike me nr. TR2T120225634310, e cila furnizon objektin në adresën e referuar në ankesë, rezulton e regjistruar me titullar Bashkia Tiranë. Sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i faturimit, kontrata është në kategorinë familjare dhe për të rezulton një gjendje debie e akumuluar nga periudhat e faturimit të mëparshme.*

*Në këtë kuadër, sqarohet se FSHU SH.A., në ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative dhe operacionale i referohet kontratës së furnizimit dhe gjendjes së debisë së lidhur me të. Procedurat e analizës dhe ndjekjes së debitorëve kryhen mbi bazën e numrit të kontratës dhe detyrimeve të saj, pa disponuar apo administruar të dhëna mbi identitetin e përdoruesve faktikë të energjisë elektrike në një objekt të caktuar, përveç rasteve kur këta rezultojnë titullarë të kontratës.*

*Në këtë kuptim, nga verifikimet e kryera nuk rezulton që V. Q. të jetë titullar i kontratës së furnizimit me energji elektrike, dhe për rrjedhojë shoqëria nuk disponon të dhëna lidhur me statusin social apo gjendjen personale të tij.*

*Gjithashtu, theksojmë se marrëdhënia kontraktore për furnizimin me energji elektrike krijohet dhe administrohet në raport me titullarin e kontratës së furnizimit, ndërsa çështjet që lidhen me përdorimin e objektit apo marrëdhëniet e strehimit siç janë në rastin e banesave sociale janë jashtë kompetencave të OSHEE Group dhe shoqërive të grupit.*

*Sa më sipër, duke marrë në konsideratë natyrën e të dhënave e administruara në sistemin e faturimit, nuk rezulton që veprimet e ndërmarra në lidhje me kontratën e furnizimit në fjalë të jenë të lidhura me karakteristika personale apo me ndonjë nga shkaqet e mbrojtura nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Bashkëngjitur e-mail-it të sipërcituar, OSHEE sh.a., vuri në dispozicion të Komisionerit të dhënat e debisë së kontratës TR2T120225634310

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankuesit**

Mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe Vërtetimin për lloj dhe masë pensioni të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, datë 18.03.2025, vërtetohet se V. Q. është përfitues i pensionit të Invaliditetit Urban, në masën 34.360 lekë<sup>6</sup>.

Me Vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 73, datë 15.10.2025 *“Për sistemimin në banesat sociale me qira, Shkozë, të disa familjeve në nevojë”*, është vendosur sistemimi i disa familjeve në nevojë, ndër to edhe V. Q., në banesat sociale në zonën e Shkozës, ish-fonderia Mekanike për një afat 1-vjeçar.

---

<sup>6</sup> Dokumentacion i administruar në ankesën nr. 44, datë 24.02.2025, të V. Q.

Në zbatim të VKB-së sipërcituar, V. Q. më datë 28.10.2025, ka nënshkruar Kontratën e Huapërdorjes pa kundërshpërblim Nr. 4150 prot., për një afat 1-vjeçar, me Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike të Bashkisë Tiranë, në zbatim të së cilës është akomoduar në banesën me adresë Kompleksi “Fusha”, shk. 2, ap. 3/1.

Në nenin 7 “*Të drejtat dhe detyrimet e huamarrësit*”, të Kontratës së Huapërdorjes, parashikohet ndër të tjera se: “7.1 *Huamarrësi do ta përdorë apartamentin ekskluzivisht vetëm për qëllimet e specifikuar në këtë Kontratë;*

*7.2 Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë shpenzimet për ngrohjen, ajrin e kondicionuar, ujin, elektricitetin, pastrimin e ndërtesës, sigurinë dhe mirëmbajtjen e përditshme të pajisjeve elektrike, elektronike dhe mekanike, për funksionimin e mirë të godinës, mirëmbajtjen e përditshme të apartamentit dhe për çdo shpenzim tjetër të zakonshëm lidhur me mirëmbajtjen e ndërtesës, të shkaktuar në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtë;*

*7.3 Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të paguajë çdo tarifë që lidhet me elektricitetin dhe ujin që buron nga kontratat me OSHEE sh.a. dhe UKT;*

*Nr. i Kontratës OSHEE — 634310*

*Nr. i Kontratës UKT — 374494”.*

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike të Bashkisë Tiranë, në momentin që ankuesi ka marrë në dorëzim apartamentin, është informuar për ekzistencën e një debie të mbartur nga përfituesit e mëparshëm në lidhje me furnizimin me energji elektrike, si dhe është sqaruar se përgjegjësia e tij financiare fillon nga data e marrjes në dorëzim të banesës, përkatësisht për konsumin e realizuar prej tij nga muaji Nëntor 2025 dhe në vijim.

Në muajin Shkurt 2026, mbështetur në provat e administruara, rezulton se banesës së V. Q., i është ndërprerë furnizimi me energji elektrike. Pas verifikimeve të kryera dhe të pranuar prej tij, rezultoi se V. Q. nuk kishte shlyer detyrimet e faturave të energjisë elektrike për konsumin e muajve Nëntor 2025, Dhjetor 2025 dhe Janar 2026. Si pasojë e mospërbushjes së këtij detyrimi financiar për periudhën në të cilën ai ka qenë përdorues i banesës dhe konsumator i energjisë elektrike, OSHEE sh.a. kishte proceduar me ndërprerjen e furnizimit, në përputhje me kushtet kontraktore dhe rregullat e zbatueshme për rastet e mospagesës.

Në vijim, rezulton se, pasi V. Q. ka kryer pagesën e detyrimeve të papaguara për periudhën përkatëse, më datë 26.02.2026, i është kryer rilidhja e energjisë elektrike në banesën në përdorim nga ana e OSHEE-së.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Bashkia Tiranë, nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale, ka vepruar brenda kompetencave të saj ligjore duke i ofruar V. Q. banesë sociale dhe duke e informuar mbi detyrimet kontraktore, përmes nënshkrimit të Kontratës së Huapërdorjes së apartamentit që ka marrë në përdorim.

Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në Pjesën V të tij rregullon të drejtën e detyrimeve, duke përcaktuar rregullat themelore që qeverisin marrëdhëniet juridike ndërmjet palëve në kuadrin e detyrimeve kontraktore dhe jashtëkontraktore. Në tërësinë e saj, Pjesa V e Kodit Civil synon të garantojë sigurinë juridike të marrëdhënieve kontraktore dhe respektimin e vullnetit të palëve ashtu siç është shprehur në aktet juridike të nënshkruara prej tyre.

Sa më sipër në Pjesën V të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, parashikohet ndër të tjera se:  
“Neni 659

*Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.*

*Neni 660*

*Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi.*

*Neni 662*

*Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës.*

*Neni 676*

*Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.*

*Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore...”*

Në zbatim të parashikimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kontrata përbën marrëveshjen ndërmjet palëve për të krijuar, ndryshuar ose shlyer një marrëdhënie juridike, e cila, ka fuqi ligjore ndërmjet palëve nënshkruese dhe duhet të zbatohet me mirëbesim.

V. Q., në cilësinë e huamarrësit, ka nënshkruar me vullnet të lirë Kontratën e Huapërdorjes pa kundërshpërblim Nr. 4150 prot., datë 28.10.2025. Me aktin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ankuesi ka pranuar shprehimisht të gjitha detyrimet që burojnë prej saj, duke përfshirë detyrimin e parashikuar në nenin 7.3, sipas të cilit huamarrësi është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për pagimin e çdo tarife që lidhet me furnizimin me energji elektrike dhe ujë.

Ky detyrim kontraktual mbështetet drejtpërdrejt në parashikimet e Kodit Civil, i cili parashikon se çdo person që nënshkruan një kontratë merr përsipër detyrime juridike të detyrueshme, si dhe moszbatimi i detyrimit kontraktual sjell përgjegjësi civile. Për rrjedhojë, mospagesa e faturave të energjisë elektrike për periudhën Nëntor 2025 - Janar 2026, periudhë gjatë së cilës ankuesi ka qenë faktikisht përdorues i banesës dhe konsumator i energjisë elektrike, përbën shkelje të qartë të detyrimit kontraktual të marrë përsipër prej tij.

Komisioneri vëren se fakti që kontrata e furnizimit me OSHEE sh.a. është e regjistruar në emër të Bashkisë Tiranë nuk e çliron ankuesin nga detyrimet financiare të lindura nga konsumi i tij, të cilat janë shprehimisht të parashikuara në nenin 7.3 të Kontratës së Huapërdorjes.

Në këtë kontekst, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike nga ana e OSHEE sh.a. është pasojë e drejtpërdrejtë e moszbatimit të detyrimit kontraktual nga ana e ankuesit dhe jo rezultat i ndonjë veprimi të padrejtë ndaj ankuesit.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Tiranë/ Drejtoria e Programeve Sociale dhe Monitorimit të Strehimit.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Bashkia Tiranë, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të V. Q. nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)